

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr. 2954 prot.Tiranë, më 13.07/2022

URDHËR

Nr. 413, datë 13.07.2022

"PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË QENDRËS SHËNDETËSORE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Nenit 9, pika 4 dhe Nenit 29, të Ligjit Nr. 10 107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Nenit 10, pika 1/a, të Ligjit Nr. 10383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimit Nr. 405, datë 20.05.2020, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor në Shqipëri 2020-2025" dhe relacionit të Grupit të Punës, të ngritur me Urdhrin Nr. 165, datë 08.03.2022, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit të Rrjetit të Integruar dhe Statutit Tip të institucioneve të shërbimit të kujdesit parësor"

URDHËROJ:

1. Miratimin e Statutit të Qendrës Shëndetësore, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij Urdhri.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Operatori Qendror i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe drejtoritë rajonale të tij, Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Qendrat Shëndetësore dhe personeli i punësuar pranë tyre.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Manastirliu



STATUTI I QENDRËS SHËNDETËSORE

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe misioni

1. Ky statut ka për qëllim të rregullojë mënyrën e funksionimit të Qendrës Shëndetësore në të gjithë territorin e vendit si dhe mënyrën e ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor në këto qendra.
2. Misioni i Qendrës Shëndetësore është t'i ofrojë komunitetit shërbim shëndetësor parësor të cilësisë së lartë, të plotë, të vazhdueshëm, të integruar dhe të arritshëm nga të gjithë. Personeli i Qendrës Shëndetësore i përgjigjet nevojave shëndetësore të pacientëve në kuadër të mjekësisë familjare, kryesisht nëpërmjet promovimit shëndetësor, parandalimit të sëmundjeve, si dhe kujdesit kurativ e paliativ.
3. Qendra Shëndetësore ka detyrim të zbatojë legjislacionin shqiptar, aktet nënligjore në fuqi, udhëzimet dhe urdhrat e nxjerra nga Ministri përgjegjës për shëndetësinë, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Fondi i Sigurimeve të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe autoriteteve shëndetësore vendore të autorizuara nga Ministri përgjegjës për shëndetësinë.

KREU II

MODELI, SHËRBIMET DHE ORGANIZIMI I PUNËS

I QENDRAVE SHËNDETËSORE

Neni 2

Përkufizime

Në këtë statut, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. **Qendra Shëndetësore** është institucion i shërbimit shëndetësor, me financim publik, jo fitimprurës që ofron kujdes shëndetësor parësor. Qendrat Shëndetësore janë në varësinë e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtorive Rajonale dhe Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor ku shtrijnë veprimtarinë e tyre.

2. **Ambulancë** është njësia më e vogël e ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor në varësi të Qendrës Shëndetësore, e cila ndahet në dy kategori: të Tipit A (shërbim me mjek dhe infermier) dhe të Tipit B (shërbim kryesisht infermieror).

Neni 3

Tipet e Qendrave Shëndetësore

1. **Qendra Shëndetësore bazë** është institucioni i shërbimit shëndetësor me financim publik, jo fitimprurës që ofron kujdes shëndetësor parësor bazuar në paketën e shërbimeve shëndetësore si dhe bazën ligjore në fuqi.
2. **Qendra socio-shëndetësore** është institucion i shërbimit shëndetësor, me financim publik, jo fitimprurës që ofron kujdes shëndetësor parësor si dhe shërbime sociale që vijnë si pasojë e sëmundjeve kronike dhe/ose akute. Qendra Socio-shëndetësore mundëson ofrimin e shërbimeve të integruara për t'iu përgjigjur nevojave të individëve dhe grupeve në nevojë duke garantuar lidhjen dhe koordinimin me nivelet e tjera të sistemit shëndetësor, me komunitetin dhe shërbimet sociale.
3. **Qendra Shëndetësore 24/7** është institucion i shërbimit shëndetësor, me financim publik, jo fitimprurës që ofron kujdes shëndetësor parësor si dhe të urgjencës 24 orëshe për qytetarët e zonës së mbulimit. Qendrat Shëndetësore 24/7 nënklasifikohen në **Qendra Shëndetësore 24/7 Tipi A** dhe **Qendra Shëndetësore 24/7 Tipi B** në varësi të:
 - a. Numrit të banorëve që mbulon zona sipas relievit (këtu përfshihen jo vetëm banorët që mbulon kjo qendër shëndetësore por edhe banorët e qendrës shëndetësore fqinje që do të mbulojë për shërbimin e urgjencës)
 - b. Kapacitetet e burimeve njerëzore në nivel Qendre Shëndetësore / Njësie Vendore të Kujdesit Shëndetësor.
 - c. Aksesit në sistemin rrugor lokal dhe kombëtar;
4. **Qendra Shëndetësore e Specialiteteve** është institucion i shërbimit shëndetësor, me financim publik, jo fitimprurës që ofron shërbime të specializuara ambulatorie diagnostikuese apo trajtuese të kujdesit shëndetësor dhe shërbimet shëndetësore të specializuara laboratorike, imazherike dhe rehabilituese për qytetarët e zonës së mbulimit.

Neni 4

Organizimi administrativ i Qendrave Shëndetësore

1. Qendra Shëndetësore është një organizim që përfshin dy ose më shumë ambulanca. Personeli i Qendrës Shëndetësore përbëhet nga drejtuesi i qendrës, personeli i shkencave mjekësore, personeli i shkencave mjekësore teknike dhe personeli administrativ/mbështetës.
2. Struktura e qendrave shëndetësore miratohet me urdhër të Ministrit përgjegjës për shëndetësinë, me propozim të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, bazuar në të dhënat e marra nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor.

3. Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor janë institucionet të cilat në nivel hierarkik janë drejtpërdrejtë përgjegjës për ofrimin e shërbimit shëndetësor nga Qendra Shëndetësore.

Neni 5

Shërbimet shëndetësore në Qendrat shëndetësore

1. Qendrat Shëndetësore ofrojnë shërbime të kujdesit shëndetësor parësor sipas paketës bazë të kujdesit shëndetësor parësor të miratuar.
2. Qendrat Shëndetësore ofrojnë shërbime të shëndetit publik në zbatim të bazës ligjore, udhëzimeve, rregullave dhe protokolleve të miratuara për kontrollin e infeksioneve me synim parandalimin, minimizimin dhe luftimin e përhapjes së infeksioneve në popullatën e zonës së mbulimit, tek të sëmuret si dhe tek stafet shëndetësore që vijnë si rrjedhojë e përkujdesjes mjekësore.
3. Qendrat Socio - shëndetësore ofrojnë shërbime shëndetësore dhe sociale të shkaktuara nga sëmundja; të integruara për t'iu përgjigjur nevojave individuale të individëve dhe grupeve në nevojë duke garantuar lidhjen dhe koordinimin me nivelet e tjera të sistemit shëndetësor, me komunitetin dhe shërbimet sociale.
4. Qendra Shëndetësore duhet të garantojë që personeli i saj të ofrojë shërbime shëndetësore cilësore, bazuar në njohuritë e reja dhe teknologjinë mjekësore, për të cilën Qendra Shëndetësore do të vendosë në dispozicion mjetet e diagnostikimit, pajisjet mjekësore dhe barnat e përcaktuara sipas standardeve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.
5. Shërbimet bazë të Kujdesit Shëndetësor Parësor që ofrohen sipas modeleve të qendrave shëndetësore janë:

I. Qendra Shëndetësore

- a. Kujdesi shëndetësor për mirërritjen dhe zhvillimin tek fëmijët;
- b. Kujdesi shëndetësor për gratë shtatzëna;
- c. Kujdesi shëndetësor seksual dhe riprodhues;
- d. Kujdesi shëndetësor për të rriturit;
- e. Kujdesi shëndetësor për të moshuarit;
- f. Kujdesi shëndetësor mendor;
- g. Kujdesin shëndetësor në banesë për banorët që mbulon me shërbim;
- h. Kujdesi i planifikuar në banesë për pacientët kronike dhe me pamundësi aksesit të drejtpërdrejtë në ambientet e Ambulancës/Qendrës Shëndetësore;
- i. Promocioni dhe edukimi shëndetësor;
- j. Kujdesi për rastet e urgjencës (ndihmën e parë për urgjencat mjekësore)
- k. Aktivitete të survejancës për sëmundjet ngjitëse (investigim rasti, përgjigje ndaj epidemive, etj);
- l. Kontrolli shëndetësor bazë;
- m. Shërbime të imunizimit/vaksinimit;
- n. Shërbimi bazik i laboratorit klinik*
- o. Shërbimi i imazherisë bazike*
- p. Shërbimi i fizioterapisë*

q. Shërbime të higjenës komunitare.

Për tre shërbimet e mësipërme (pika n, o dhe p), qendra shëndetësore i ofron në varësi të numrit të popullatës që mbulon, numrit të mjekëve në dispozicion, infrastrukturës fizike, buxheteve në dispozicion, sëmundshmërisë në komunitet dhe miratimit nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

I - A Ambulanca Tipi A (me mjek dhe infermier)

- a. Kujdesi shëndetësor për mirërritjen dhe zhvillimin tek fëmijët;
- b. Kujdesi shëndetësor për gratë shtatzëna;
- c. Kujdesi shëndetësor seksual dhe riprodhues;
- d. Kujdesi shëndetësor për të rriturit;
- e. Kujdesi shëndetësor për të moshuarit;
- f. Kujdesi shëndetësor mendor;
- g. Kujdesin shëndetësor në banesë për banorët që mbulon me shërbim;
- h. Kujdes I planifikuar në banesë për pacientët kronikë dhe me pamundësi aksesit të drejtpërdrejtë në ambientet e Ambulancës/ Qendrës Shëndetësore;
- i. Promocioni dhe edukimi shëndetësor;
- j. Kujdesi për rastet e urgjencës (ndihmën e parë për urgjencat mjekësore);
- k. Aktivitete tëurvejancës për sëmundjet ngjitëse (investigim rasti, përgjigje ndaj epidemive, etj);
- l. Kontrolli shëndetësor bazë;
- m. Shërbime të imunizimit/vaksinimit;
- n. Shërbime të higjenës komunitare;
- o. Shërbimi bazik i laboratorit klinik*
- p. Shërbimi i imazherisë bazike*
- q. Shërbimi i fizioterapisë*

Për tre shërbimet e mësipërme (pika o, p dhe q), qendra shëndetësore i ofron në varësi të numrit të popullatës që mbulon, numrit të mjekëve në dispozicion, infrastrukturës fizike, buxheteve në dispozicion, sëmundshmërisë në komunitet dhe miratimit nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

I - B Ambulanca Tipi B (kryesisht shërbim infermieror)

- a. Kujdesi shëndetësor infermieror për mirërritjen dhe zhvillimin tek fëmijët;
- b. Kujdesi shëndetësor infermiero-mami për gratë shtatzëna;
- c. Kujdesi shëndetësor infermieror për aspektin seksual dhe riprodhues;
- d. Kujdesi shëndetësor infermieror për të rriturit;
- e. Kujdesi shëndetësor infermieror për të moshuarit;
- f. Kujdesi shëndetësor infermieror për shëndetin mendor;
- g. Kujdesin shëndetësor në banesë për banorët që mbulon me shërbim;
- h. Kujdesi i planifikuar në banesë për pacientët kronikë dhe me pamundësi aksesit të drejtpërdrejtë në ambientet e Ambulancës/ Qendrës Shëndetësore;
- i. Promocioni dhe edukimi shëndetësor;
- j. Kujdesi për rastet e urgjencës në nivel infermieror sipas protokolleve (ndihmën e parë për urgjencat mjekësore);

- k. Aktivitete të survejancës për sëmundjet ngjitëse (investigim rasti, përgjigje ndaj epidemive, etj);
- l. Promocion dhe ndjekje e ecurisë së zhvillimit të kontrollit shëndetësor bazë për banorët që mbulon;
- m. Shërbime të imunizimit/vaksinimit, sipas protokolleve dhe udhëzimeve në fuqi;
- n. Shërbime të përkujdesjes psiko-sociale në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse brenda Qendrës Shëndetësore (kjo në rastet e Qendrës Shëndetësore Socio-Shëndetësore);
- o. Shërbime të higjenës komunitare.

II. Qendra Socio- Shëndetësore:

- a. Kujdesi shëndetësor për mirërritjen dhe zhvillimin tek fëmijët;
- b. Kujdesi shëndetësor për gratë shtatzëna;
- c. Kujdesi shëndetësor seksual dhe riprodhues;
- d. Kujdesi shëndetësor për të rriturit;
- e. Kujdesi shëndetësor për të moshuarit;
- f. Kujdesi shëndetësor mendor;
- g. Kujdesin shëndetësor në banesë për banorët që mbulon me shërbim;
- h. Kujdes i planifikuar në banesë për pacientët kronikë dhe me pamundësi aksesit të drejtpërdrejtë në ambientet e Ambulancës/ Qendrës Shëndetësore;
- i. Promocioni dhe edukimi shëndetësor;
- j. Kujdesi për rastet e urgjencës (ndihmën e parë për urgjencat mjekësore);
- k. Aktivitete të survejancës për sëmundjet ngjitëse (investigim rasti, përgjigje ndaj epidemive, etj);
- l. Kontrolli shëndetësor bazë;
- m. Shërbime të imunizimit/vaksinimit;
- n. Shërbimet e kujdesit shëndetësor në banesë;
- o. Shërbim Psiko- Social pranë Qendrës Shëndetësore/Komunitet;
- p. Kujdes shëndetësor të integruar pranë Qendrës Shëndetësore /Komunitet;
- q. Shërbimi bazik i laboratorit klinik*
- r. Shërbimi i imazherisë bazike*
- s. Shërbimi i fizioterapisë*
- t. Shërbime të higjenës komunitare.

Për tre shërbimet e mësipërme (pika q, r dhe s), qendra shëndetësore i ofron në varësi të numrit të popullatës që mbulon, numrit të mjekëve në dispozicion, infrastrukturës fizike, buxheteve në dispozicion, sëmundshmërisë në komunitet dhe miratimit nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

Qendra Shëndetësore 24/7:

1) Tipi A

- a. Kujdesi shëndetësor për mirërritjen dhe zhvillimin tek fëmijët;
- b. Kujdesi shëndetësor për gratë shtatzëna;
- c. Kujdesi shëndetësor seksual dhe riprodhues;
- d. Kujdesi shëndetësor për të rriturit;

- e. Kujdesi shëndetësor për të moshuarit;
- f. Kujdesi shëndetësor mendor;
- g. Kujdesin shëndetësor në banesë për banorët që mbulon me shërbim;
- h. Kujdes i planifikuar në banesë për pacientët kronikë dhe me pamundësi aksesit të drejtpërdrejtë në ambientet e Ambulancës/ Qendrës Shëndetësore;
- i. Promocioni dhe edukimi shëndetësor;
- j. Shërbimi i Urgjencës mjekësore 24/7 me shtretër në nivel mjekësor dhe infermieror;
- k. Aktivitete tëurvejancës për sëmundjet ngjitëse (investigim rasti, përgjigje ndaj epidemive, etj);
- l. Kontrolli shëndetësor bazë;
- m. Shërbime të imunizimit/vaksinimit;
- n. Shërbimi i imazherisë bazike;
- o. Shërbimi i laboratorit Klinik+Biokimik;
- p. Shërbimi i fizioterapisë;
- q. Shërbimet e kujdesit shëndetësor në banesë;
- r. Kujdes shëndetësor të integruar;
- s. Shërbime të higjenes komunitare.

2) Tipi B

- a. Kujdesi shëndetësor për mirërritjen dhe zhvillimin tek fëmijët;
- b. Kujdesi shëndetësor për gratë shtatzëna;
- c. Kujdesi shëndetësor seksual dhe riprodhues;
- d. Kujdesi shëndetësor për gratë dhe shëndeti riprodhues;
- e. Kujdesi shëndetësor për të rriturit;
- f. Kujdesi shëndetësor për të moshuarit;
- g. Kujdesi shëndetësor mendor;
- h. Kujdesin shëndetësor në banesë për banorët që mbulon me shërbim;
- i. Kujdes i planifikuar në banesë për pacientët kronikë dhe me pamundësi aksesit të drejtpërdrejtë në ambientet e Ambulancës/ Qendrës Shëndetësore;
- j. Promocioni dhe edukimi shëndetësor;
- k. Kujdesi i shërbimit të urgjencës mjekësore 24/7 në nivel infermieror;
- l. Aktivitete tëurvejancës për sëmundjet ngjitëse, (investigim rasti, përgjigje ndaj epidemive, etj);
- m. Kontrolli shëndetësor bazë;
- n. Shërbime të imunizimit/vaksinimit;
- o. Shërbimet e kujdesit shëndetësor në banesë;
- p. Kujdes shëndetësor të integruar;
- q. Shërbime të higjenes komunitare;

III. Qendra Shëndetësore të specialiteteve:

- a. Vizita/Konsulta e pacientit nga mjekët specialistë;
- b. Aplikimi i metodave të diagnostikimit/Trajtimit dhe ndjekjes në dinamikë të pacientit;
- c. Referimi në sistemin spitalor;
- d. Plotësimi i dokumentacionit klinik të përcaktuar autoritetet zyrtare të ngarkuara në bazën ligjore
- e. Shërbime laboratorike Biokimike + Klinike + Bakteriologjike;
- f. Shërbime imazherike të zgjeruara;
- g. Procedura specifike të specializuara të diagnostikimit, të trajtimit dhe ndjekjes të pacientëve.

Neni 6

Organizimi i punës në Qendrat Shëndetësore

1. Qendrat Shëndetësore janë përgjegjëse për organizimin e punës dhe funksionimin e brendshëm të proceseve të ofrimit të shërbimeve dhe aktiviteteve në njësinë bazë të saj si edhe në pikat shëndetësore apo ambulancat në territorin e zonës së mbulimit.
2. Qendrat Socio-Shëndetësore, Qendrat Shëndetësore të Specialiteteve dhe Qendrat Shëndetësore Bazë ofrojnë shërbimet e kujdesit socio-shëndetësor parësor me ndërprerje (me një ose me dy turne).
3. Ministri përgjegjës për shëndetësinë miraton hartën e shpërndarjes, standardet e infrastrukturës ndërtimore, pajisjeve mjekësore dhe të burimeve njerëzore të shërbimit të urgjencës në kujdesin parësor, të propozuar nga Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor.
4. Personeli i Qendrës Shëndetësore ofron shërbimin shëndetësor për banorët në zbatim të grafikut/orarit të afishuar pranë Qendrës Shëndetësore dhe disiplinës në punë.
5. Personeli, i cili punon në qendër shëndetësore duhet të jetë i licencuar sipas legjislacionit në fuqi. Licenca të jetë e vlefshme dhe të ketë realizuar kreditet e kërkuara të edukimit profesional në vazhdim.
6. Në rastin e mungesave të përkohëshme në punë të mjekëve, të cilët janë më tepër se koha e lejes së zakonshme apo mbi 14 (katërmëdhjetë) ditë të raporteve mjekësore, Qendra Shëndetësore duhet të riorganizojë personelin mjekësor me qëllim ofrimin e shërbimit shëndetësor, për të gjithë banorët me miratim të Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor.
7. Qendra Shëndetësore angazhon personelin shëndetësor mjek dhe infermier, për të punuar në shërbimin e urgjencës pranë Qendrës Shëndetësore 24/7, spitaleve Bashkiake/Rajonale të njësisë administrative dhe/ose njësive administrative afër, ku ushtron aktivitetin, me kërkesë të Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor (për rastet e Qendrës Shëndetësore 24/7) dhe Drejtorive rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor në rastin e Shërbimit Spitalor, në zbatim të Urdhrave apo Udhëzimeve të nxjerra nga Drejtoria Qendrore e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Ministria përgjegjëse për shëndetësinë.
8. Qendra Shëndetësore duhet minimalisht të mbajë në mjediset e saj barna apo materiale mjekimi që janë të miratuara dhe të përcaktuara në "Listën e barnave të urgjencës dhe materialeve të mjekimit" të paketës së shërbimeve shëndetësore. Qendra Shëndetësore mund të pasurojë listën e shërbimeve shëndetësore të ofruara duke siguruar pajisje mjekësore të nevojshme pas miratimit nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

Neni 7

Transparenca dhe Informimi i Qytetarëve

1. Qendra Shëndetësore duhet të ketë të afishuar në një vend të dukshëm për qytetarët, brenda mjediseve të saj strukturën organizative, sipas mjekëve dhe shërbimeve, grafikun përkatës dhe orarin e shërbimeve, paketën bazë të shërbimeve të kujdesit shëndetësor që ofron dhe tarifat e miratuara për shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor dhe shërbime administrative të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.
2. Qendra shëndetësore, duhet të organizojë një sistem dhe vend të posaçëm për mbledhjen sistematike të opinionëve, ankesave, vërejtjeve dhe sugjerimeve nga ana e pacientëve edhe qytetarëve lidhur me shërbimin e ofruar.
3. Qendra Shëndetësore raporton në Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor të gjitha rastet në të cilat shprehen ankesa nga qytetarët për mangësi në ofrimin e shërbimit dhe jo vetëm.

KREU III

PËRGJEGJËSITË E QENDRËS SHËNDETËSORE

Neni 8

Përgjegjësitë e Qendrës Shëndetësore në dhënien e shërbimeve shëndetësore

1. Qendra shëndetësore duhet të ofrojë shërbimet socio - shëndetësore për qytetarët me cilësi dhe në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.
2. Qendra shëndetësore, duhet të garantojë ofrimin e shërbimeve socio – shëndetësore për qytetarët pa asnjë lloj dallimi apo diskriminimi. Ajo ruan plotësisht fshehtësinë e të dhënave dhe informacionin shëndetësor të çdo qytetari, pa cënuar dinjitetin dhe integritetin.
3. Qendra shëndetësore, duhet të sigurojë dhe ofrojë shërbim socio – shëndetësor të gjithëanshëm dhe të integruar, duke përfshirë dhe shërbimin shëndetësor në komunitet, si dhe këshillimin, promovimin shëndetësor, parandalimin e sëmundjeve sipas udhërrëfyeseve apo protokolleve klinike të miratuara të menaxhimit të sëmundjeve.
4. Qendra Shëndetësore, duhet të përmbushë standardet e miratuara nga Ministri përgjegjës për shëndetësinë për institucionet e kujdesit shëndetësor parësor dhe në zbatim të ligjit për kujdesin shëndetësor dhe akteve nënligjore në fuqi.
5. Qendra shëndetësore, duhet të punojë për plotësimin e standardeve të nkreditimit, si dhe të garantojë mbarëvajtjen e aktivitetit shëndetësor pas plotësimit të tyre.
6. Qendra shëndetësore, duhet të përmbushë indikatorët e performancës dhe të cilësisë së shërbimit shëndetësor të ofruar, në zbatim të detyrimeve kontraktuale, urdhrave dhe udhëzimeve të Ministrisë

përgjegjës për shëndetësinë, strukturave përkatëse të autorizuar nga Ministri si dhe indikatorëve të përcaktuar nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

7. Qendra shëndetësore, duhet të zbatojë sistemin e referimit për shërbimet shëndetësore në zbatim të urdhërit të Ministrit përgjegjës për shëndetësinë.
8. Qendra Shëndetësore është përgjegjëse për regjistrimin e banorëve, nëpërmjet personelit mjekësor të kontraktuar. Banorët zgjedhin Mjekun e Përgjithshëm dhe të Familjes në bazë të parimit të zgjedhjes së lirë. Pjesëtarët e një familjeje rekomandohet të regjistrohen tek i njëjti mjek.
9. Numri i banorëve të regjistruar tek një Mjek i Përgjithshëm dhe i Familjes, duhet të jetë në përputhje me standardet që ka përcaktuar Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, bazuar në aktet nënligjore të dala nga Ministria përgjegjëse për Shëndetësinë. Mjeku i Përgjithshëm dhe i Familjes, janë të detyruar të bëjnë mbulimin shëndetësor të banorëve, mbi normën e standarteve të miratuara, vetëm atëherë kur nuk ka alternativë tjetër.
10. Struktura e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor janë institucionet përgjegjëse për rishpërndarjen e banorëve në çdo rast që gjykojnë se kjo sjell përmirësim të ofrimit të shërbimeve socio - shëndetësore. Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm i Kujdesit Shëndetësor janë institucionet përgjegjëse për monitorimin e regjistrit elektronik të banorëve.
11. Qendra Shëndetësore në praktikat dhe aktivitetet e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor zbaton sistemet e raportimit dhe të informacionit shëndetësor të miratuara nga Ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe autoritetet shëndetësore të autorizuar për këtë qëllim. Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm i Kujdesit Shëndetësor janë institucione të cilat ndërveprojnë për të mundur mirëfunksionimin dhe standardizimin e të dhënave shkresore dhe elektronike që Qendra Shëndetësore raporton nëpërmjet sistemeve elektronike dhe/ose shkresore.
12. Qendra Shëndetësore, duhet të ruajë dhe të mirëmbajë të gjitha pajisjet, aparaturat mjekësore, si dhe sistemet e informacionit që ka në përdorim për ofrimin e paketës së shërbimeve, si dhe është përgjegjëse për mbrojtjen nga dëmtimi / vjedhja apo humbja e shkaktuar nga pakujdesia dhe neglizhenca. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor është institucioni i drejtpërdrejtë përgjegjës për garantimin e ofrimit shërbimit shëndetësor dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës, pajisjeve dhe sistemeve nga ana e Qendrës Shëndetësore.

Neni 9

Financimi i Qendrës Shëndetësore

1. Qendra Shëndetësore financohet nga:
 - a. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë;
 - b. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
 - c. Burime të tjera sipas legjislacionit në fuqi.
2. Qendra Shëndetësore dhe Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor si një palë e vetme lidhin kontratën për financim me Drejtorinë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Qendra shëndetësore është përgjegjëse për mirëmbajtjen e investimeve infrastrukturore të kryera nga Ministria përgjegjëse për shëndetësinë apo dhe nga burime të tjera financimi.
4. Qendra Shëndetësore është përgjegjëse për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe aparaturave mjeksore, si dhe atyre të kabinetit të kontrollit mjekësor bazë.
5. Qendra shëndetësore është përgjegjëse për zbatimin e masave të nevojshme për magazinimin dhe largimin e mbeturinave të kontaminuara nga procedurat mjeksore dhe mbetje spitalore të rrezikshme.
6. Qendra Shëndetësore administron dhe përdor të ardhurat dytësore të krijuara sipas udhëzimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

Neni 10

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Drejtorit të Qendrës Shëndetësore

1. Qendra shëndetësore përfaqësohet nga Drejtori i Qendrës Shëndetësore, i cili përzgjidhet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria Qendrore e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.
2. Drejtori i Qendrës Shëndetësore është përgjegjës për të siguruar mbarëvajtjen e punës në qendrën shëndetësore si në aspektin administrativ ashtu edhe në atë profesional.
3. Veprimtaria e Qendrës Shëndetësore duhet të organizohet dhe udhëhiqet në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Drejtuesi i Qendrës Shëndetësore organizon punën për administrimin dhe popullimin e “Regjistrat elektronik të banorëve me banim të përhershëm”, përditësimin dhe transferimin e listës së pacientëve nga njëri mjek tek tjetri. Përgjigjet për organizimin, mirëfunksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të informacionit shëndetësor, në kujdesin parësor.
5. Drejtori i Qendrës Shëndetësore është përgjegjës për menaxhimin e aktivitetit të përgjithshëm lidhur me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor për të gjithë banorët nën juridiksionin e qendrës si dhe për banorët e zonës që mbulon me shërbim. Ai ka këto detyra:
 - a. Siguron arritjen e rezultateve në kohë dhe me cilësi, sipas objektivave të planifikuara;
 - b. Lidh kontratat e punës me punonjësit e Qendrës Shëndetësore, bazuar në procedurat e rekrutimit të personelit të miratuara nga Ministria përgjegjëse për shëndetësinë;
 - c. Mat performancën e personelit të Qendrës Shëndetësore në mënyrë periodike duke u bazuar në indikatorët e vendosur nga strukturat përgjegjëse në sistemin shëndetësor;
 - d. Siguron zbatimin e protokolleve mjeksore të miratuara;
 - e. Drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë financiare të institucionit, zbaton buxhetin e Qendrës Shëndetësore;
 - f. Është përgjegjës për edukimin e vazhdueshëm profesional dhe trajnimin e personelit të Qendrës Shëndetësore;
 - g. Menaxhon implementimin e standardeve të cilësisë;
 - h. Garanton mbajtjen e sistemit të informimit shëndetësor;

- i. Raporton sipas kërkesave dhe treguesve të miratuar si për mbarëvajtjen e punës në qendrën që drejton tek strukturat e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
- j. Bashkëpunon me pushtetin vendor për mbarëvajtjen e qendrës shëndetësore.

KREU IV

PUNËSIMI DHE KUALIFIKIMI

Neni 11

Punësimi

1. Drejtori i Qendrës Shëndetësore emërohet dhe lirohet nga detyra nga Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, me propozim të Drejtorit të Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, pas miratimit paraprak nga Drejtori i Përgjithshëm i Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.
2. Procedura e punësimit të personelit administrativ në Qendrat Shëndetësore, zhvillohen nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor sipas udhëzimit të nxjerrë nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.
3. Mekanizmi i punësimit për teknikët e shkencave mjekësore është Portali "Infermier për Shqipërinë", ndërsa për personelin mjek është Portali "Mjek për Shqipërinë".
4. Kontratat e punës për personelin e Qendrës Shëndetësore lidhet nga Drejtori i Qendrës Shëndetësore, sipas kontratës tip të miratuar me Urdhër të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.
5. Kriteret e përgjithshme dhe mënyra e vlerësimit të punonjësve në Qendrat Shëndetësore, miratohen nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.
6. Procedurat e rekrutimit të punonjësve në Qendrat Shëndetësore mbikëqyren nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Neni 12

Koha e punës dhe e pushimit

1. Koha e punës për personelin e qendrës shëndetësore është jo më shumë se 40 orë në javë.
2. Kohëzgjatja ditore e punës është 6 orë e 40 minuta para dite dhe/ose pasdite, sipas orarit të miratuar dhe të shpallur në mjediset e qendrës shëndetësore.
3. Në raste të veçanta dhe kushte të caktuara punëdhënësi ka të drejtë të ndryshojë kohën e punës.
4. Punëmarrësi gëzon të drejtën e një dite pushim në javë, të dielën si dhe të drejtën e pushimit në ditët e festave zyrtare.

5. Punëmarrësi gëzon të drejtën e lejes vjetore me pagesë 28 ditë kalendarike gjatë vitit të punës në vazhdim.
6. Çështje të tjera lidhur me kohën e punës dhe të pushimit përcaktohen në kontratën e punës, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 13

Plotësimi i normave për indikatorë performance

1. Personeli mjekësor i punësuar në qendrën shëndetësore është i detyruar të plotësojë normat e miratuara të indikatorëve të performancës, sipas përcaktimeve në kontratën e punësimit të shërbimit përkujdesës në qendër.
2. Mungesat pa arsye dhe mosofrimi i kujdesit shëndetësor për qytetarët si dhe përcaktimeve të veçanta në kontratën e punës konsiderohen shkelje të rënda të disiplinës në punë dhe trajtohen sipas dispozitave në Kodin e Punës.

Neni 14

Kualifikime

1. Personeli mjekësor në qendrën shëndetësore duhet të ndjekë ciklin e plotësimit të krediteve të edukimit në vazhdim dhe plotësimin e krediteve të nevojshme për riliçensimin e tij.
2. Qendra Shëndetësore duhet të ofrojë aktivitete trajnuese për profesionistët e saj, në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore për edukimin në vazhdim.

KREU V

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 15

Ruajtja e dokumentacionit

1. Organizon punën për dokumentimin e aktiviteteve shëndetësore dhe administrative të kryera në Qendrën Shëndetësore sipas standarteve të parashikuara dhe përgjigjet për krijimin, administrimin, qarkullimin dhe ruajtjen e dokumentacionit zyrtar të Qendrës Shëndetësore.
2. Dokumentet e Qendrës Shëndetësore, ruhen dhe administrohen sipas rregulloreve në fuqi të Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat", i ndryshuar.

Neni 16

Vula e Qendrës Shëndetësore

Vula e Qendrës Shëndetësore miratohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 17

Dispozita kalimtare

1. Strukturat e Qendrës Shëndetësore sipas modeleve të përshkruar në këtë statut, të rishikohen brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij statuti.
2. Drejtoria Qendrore e Operatorit të Kujdesit Shëndetësor harton dhe miraton formatin tip të rregullores së brendshme sipas modeleve të Qendrës Shëndetësore.
3. Qendrat Shëndetësore duhet të hartojnë dhe përcjellin për miratim pranë Drejtorive Rajonale të Operatorit rregulloren e brendshme sipas formatit tip të miratuar brenda 6 (gjashtë) muajve të hyrjes në fuqi të këtij Statuti.

Neni 18

Hyrja në Fuqi

Ky Statut hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij me Urdhër të Ministri përgjegjës për shëndetësinë.